



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:275798
Datë: 25.03.2024
Numri i dokumentit: 05498450

PPP.nr.234/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, rr “Hazir Shala”, nr.4, kundër debitorit A.Sh. nga fsh ..., Komuna e Shtimes, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 25.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit A.Sh., i ushtruar kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.766/22, i datës 30.11.2022, i lëshuar nga përmbartuesi privat I.M., sa i përket shumës së borxhit prej 21.40 euro dhe **SHFUQUZOHET** urdhri për përmbartim sa i përket shumës së mjeteve prej 21.40 euro, ndërsa **REFUZOHET** prapësimi i debitorit A.Sh., i ushtruar kundër urdhrimit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.766/22, të datës 30.11.2022, sa i përket shumës së borxhit prej 967.52 euro dhe shpenzimeve të përmbartimit dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit sa i përket shumës së borxhit prej 967.52 euro dhe shpenzimeve të përmbartimit.

A r s y e t i m

Me urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.766/22, të datës 30.11.2022, përmbartuesi privat I.M., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga kreditori Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Prishtina” Sh.A, kundër debitorit A.Sh., për pagesën e shumës së borxhit prej 988.92 euro, në

bazë të ekstraktit të verifikuar të librave afariste të kontabilitetit, me numër ..., si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përbarimore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitorit në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përbaruesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrit mbi lejimin e përbarimit, debitori, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përbarim P.nr.766/22, i datës 30.11.2022.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të prapësimin të debitorit dhe pretendimeve në të, konstatoj se urdhri për përbarim P.nr.766/22, i datës 30.11.2022, është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm sa i përket shumës së mjeteve prej 967.52 euro, kurse nuk është i ligjshëm sa i përket shumës së mjeteve prej 21.40 euro.

Sa i përket pretendimit të debitorit në prapësim se: nuk ka asnjë provë se dokumenti i besueshëm që është në urdhrin për caktimin e përbarimit është dorëzuar nga ana e kreditorit tek debitori, gjykata këtë pretendim e konsideron të pa bazuar sepse përveç nga flet dërgesa mbi dorëzimin e urdhrit për përbarim në bazë të cilës përbaruesi privat debitorit i ka dërguar edhe ekstraktin e verifikuar nga librat afariste bashë me urdhrin për përbarim, debitori ka qenë i njoftuar me ekstraktin e verifikuar të librave afariste edhe me kryerjen e pagesave të cilat i ka bërë në emër të pagesës së borxhit.

Kurse sa i përket pretendimit të debitorit se ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve mund të kërkohet tek përbarimi, gjykata edhe këtë pretendim e konsideron të pa bazuar për arsye se në rastin konkret është shkaktuar ndërprerja e afatit të parashkrimit e paraparë në nenin 368, par 1 dhe 2, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku është paraparë shprehimisht se : *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”* dhe me shikimin e shkresave të lëndës, gjegjësisht pagesës së shumës së borxhit prej 21.40 euro

nga debitori me datën 12.12.2022, si dhe pagesat e cekura në ekstraktin e verifikua të librave afariste të kontabilitetit, me numër ..., siç është pagesa e bërë me datën 11.03.2021 në shumë prej 50 euro, Gjykata ka konstatuar se debitori e ka pranuar borxhin që e ka ndaj kreditorit dhe si rezultat i këtij fakti nuk kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit nga neni 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së. Për më tepër në nenin 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, është paraparë: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* dhe duke e krahasuar datën e fundit të pagesës së shumës së borxhit prej 21.40 euro nga debitori, e bërë më datë 12.12.2022 dhe datës kur kreditori e ka dorëzuar tek përmbaruesi privat propozimin për përmbarim, siç është data 29.11.2022, nënkupton se nuk ka kaluar afati kohor prej 1 viti i kërkuar në nenin 360 par 1, nën par 1.1, të LMD-së dhe kërkesa e kreditorit nuk është parashkruar (vjetërsuar).

Gjithashtu pretendimi i debitorit në prapsim se fatura nuk i plotëson kushtet me Ligjet e aplikueshme për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe e njëjta nuk është dokument i besueshëm, gjykata konsideron se edhe këtë pretendim nuk qëndron dhe është i pa bazuar për faktin se në bazë të nenit 29, par 1, nën par 1.2, të LPP-së, është paraparë shprehimisht se si dokument i besueshëm është edhe ekstrakti i verifikuar nga librat afariste për pagesën e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave. Andaj, gjykata konsideron se përmbaruesi privat I.M. drejtë ka vepruar kur e ka nxjerr urdhrin e atakuar në prapësim me të cilin e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori.

Po ashtu pretendimi i debitorit se dokumenti i besueshëm nuk është i përshtatshëm për përmbarim gjykata konsideron edhe ky pretendim nuk qëndron dhe është i pa bazuar sepse ekstrakti i verifikuar i librave afariste me numër ..., është në tërësi i përshtatshëm për përmbarim, gjegjësisht në pajtim të plotë me nenin 29 par.3 të LPP-së, për arsye se në të siç konstatohet është treguar kreditori, debitori si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga ekstrakti i verifikuar i librave afariste, ka vërtetuar se kreditori në këtë ekstrakt e ka shënuar edhe periudhën kohore brenda të cilës e ka kërkuar shumën e borxhit prej 988.92 euro, siç është periudha kohore prej datës 01.01.2013 e deri më datën 29.11.2022.

Gjykata me rastin e pranimit të prapësimit të debitorit sa i përket shumës së mjeteve prej 21.40 euro, mori për bazë pagesën, gjegjësisht dëftesën e pagesës së lëshuar nga kreditori e dt. 12.12.2022, në bazë të cilës vërtetohet se debitori A.Sh. me këtë datë ka bërë pagesën në emër të borxhit në shumë prej 21.40 euro.

Andaj, Gjykata bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.234/22, më datë 25.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.